

PRESS

Buletin periodik i Këshillit të Bashkësisë Lokale të fshatit Sllatinë dhe NGO "Millenium"

INTERVISTA:

Ramadan Idrizi, kandidat për deputet nga rradhët e PDSH-së.

Abaz Misimi, nga BDI

MIRËPRITET DALJA E "PRESS-it"

Numri i parë i buletinit "PRESS" u prit mirë nga lexuesit tanë, të cilët përmes tij patën mundësi që të informoheshin më detajisht me gjithçka ndodh në këtë mjedis.

Ndërkohë na arritën shumë sugjerime të mirëseardhura për të pasuruar faqet e "PRESS-it", të cilët i kemi marrë parasyshtë.

Ndërkohë vendosëm që të krijojmë edhe një Këshill Botues të "PRESS-it". Ofertave tona për të ndihmuar iu përgjigjën me shumë zemërgjërësi mjaft intelektualë nga mjedisi ynë.

Besojmë se numrat e ardhshëm do të sjellin cilësi edhe më të lartë. Kjo do të varet nga të gjithë ne.

Më së shumti na gëzon fakti se interesim për t'u inkuadruar në përgatitjen e "PRESS-it" kanë shprehur shumë studentë dhe nxënës. Shpresojmë se ky buletin do t'u shërbejë atyre edhe si një shkollë për të mësuar zanatin e gazetarisë. Ndërkohë janë paraqitur edhe sponzorët e parë, që kanë shprehur interesim për të reklamuar firmat e tyre në këtë buletin. Këta biznesmenë duke ndihmuar daljen e "PRESS-it", njëkohësisht ndihmojnë edhe në informimin sa më burimor të bashkëvendasve të tyre dhe i zgjasin jetën "PRESS-it".

Nga ky numër "PRESS" do të dalë në bashkëpunim me NGO "Millenium" nga Sllatina.



Për një fushatë të qetë zgjedhore

Qytetarët kanë më së shumti nevojë që të përjetojnë zgjedhjet parlamentare si festë, sepse u jepet rasti që me votën e tyre të përcaktohen për kandidatët dhe partitë politike që mendojnë se do të përfaqësojnë interesat e tyre. Ata më së paku kanë nevojë që zgjedhjet parlamentare të kalojnë në gjendje të tensionuar. Çdo hasmëri që do të lindte mes njerëzve do të zhvleftësonte këto zgjedhje. Fundja, qytetarët kanë të drejtën e tyre të kenë bindje politike, të kenë simpati partiake, prandaj më së paku duhet që të konfrontohen veçse u përkasin partive të ndryshme politike.

Ne fshatin Sllatinë ekzistojnë nëndegë të partive të ndryshme politike. Pavarësisht se cilës proviniencë politike i përkasin, këto nëndegë kanë treguar deri tani shkallë të lartë të kulturës politike. Shpresojmë se kjo shkallë e lartë e vetëdijes politike do të vazhdojë edhe mëtej.

Është fakt se brenda një familje mund të kemi individë që u përkasin partive të ndryshme politike dhe nëse do të kishte grindje brenda familjeve, atëherë si mund të presim që të kemi unitet brenda një familje më të madhe që quhet komb.

"Një komb i përçarë është i humbur", thoshte një mendimtar i shquar shqiptar. T'i përkasish ndonjë partie politike, kjo nuk do të thotë se i kontribuon përçarjes, përkundrazi tenton që të ofrosh një opcion plus në shoqëri. Por, nëse tenton me çdo kusht që edhe tjetri të mendojë si ti, atëherë vetëm se dikujt ia merr një të drejtë aq të madhe - të shprehë bindjet dhe mendimet e veta.

Le të tregojmë kulturë politike edhe kësaj rradhe. Le të jemi shembull për të gjithë se si duhet të bëhen zgjedhjet. Të lira dhe demokratike.

Barnatorja »MEDIKA« Sllatinë

Barna
Ushqime për fëmijë
Materiale higjienike

Pronar:
Bedri NEZIRI
Tel. 070 330 244
070 740 654



PRESS

**Buletin periodik i Këshillit të
Bashkësisë Lokale të fshatit
Sllatinë dhe NGO
"Millenium"**

Viti 1. Numri 2. Shtator 2002

Buletini periodik "PRESS" përgatitet nga komisioni për komunikim me opinionin publik pranë Këshillit të Bashkësisë Lokale.

tel. (044) 382 419

e-mail:

sllatinapres@yahoo.com

www.sllatina.cjb.net

Në këtë numër kanë ndihmuar:

*Salajdin Salihu, Bardhyl Zaimi,
Nexhbedin Shaqiri, Berat Azizi,
Blerim Jakupi, Gajur Idrizi,
Nexhbedin Veliu, Irfan
Abdullahu, Agron Pajaziti, Imer
Imeri, Agim Nuhiu, Taxhedin
Selimi, Lulzim Idrizi, Syrja Etemi,
Agron Salihu, Selam Abdiu*

Falemnderojmë firmat:

»Medika«, »Aurora«, »Shaza«,
»Qielli blu«.

Falemnderojmë institucionet:

Sh.f. »Eqerem Çabej« dhe K.F.
»Vëllazërimi«

**Vërejtjet, sugjerimet, kritikrat
dhe vlerësimet janë të
mirëseardhura.**

Fotografitë kthehen.

© **Të gjitha të drejtat e
rezervuara**

NJË DRAMATURG NORVEGJEZ SHKRUAN DRAMË PËR ADELINA ARIFIN

Norvegjezët realizojnë dramë ku si subjekt do të merret fati tragjik i nxënëses së vrarë në luftë Adelina Arifi nga Sllatina.

Familjen Arifi e kanë vizituar disa gazetarë nga televizione dhe gazeta norvegjeze, që do të shkruajnë për humbjen tragjike të jetës së saj, ndërkohë që në mesin e tyre ishte edhe një regjisor i njohur norvegjez, i cili planifikon të shkruajë një dramë ku si subjekt do të jetë jeta e Adelinës.

Sllatina ka mjaft bukuri natyrore. Vende mjaft pitoreske. Shumë sllatinas preferojnë që pushimet e fundjavës t'i kalojnë në vendin e quajtur "Tre ujërat". Mjerisht numri i atyre që shfrytëzojnë bukuritë e natyrës është shumë i vogël. Të rinjtë dhe të rejtat do të duhej që në një të ardhme të organizonin ndonjë manifestim që do të nxishte pikërisht njerëzit të shijonin këto bukuri.




Në foto është stadiumi i futbollit të vogël në vendin e quajtur Bigur. Stadiumi është ndërtuar me iniciativën e të rinjve të fshatit Sllatinë. Me një angazhim më të madh ai mund të bëhet një qendër e vërtetë rekreative dhe sportive, që edhe ashtu i mungon fshatit Sllatinë. Aktivistë të shumtë thonë se janë duke kërkuar fonde të ndryshme që të mund ta bëjmë asfaltimin. Ndërtimi i stadiumit në Bigur është një iniciativë qytetare që duhet të përshendetet nga të gjithë.

Vërejtjet, sugjerimet, kritikrat dhe vlerësimet mund t'i adresoni në Bashkësinë Lokale të fshatit Sllatinë. Të gjitha ankesat për dobësitë e Këshillit të Bashkësisë Lokale do të publikohen në numrin e ardhshëm të buletinit **"PRESS"**.


Gjithashtu mund të kontaktoni edhe përmes numrit të telefonit:

(044)382-419



Kjo faqe është e rezervuar edhe për sponzorët e buletinit "PRESS".

Reklama është çelës i suksesit, veçmas kur ndihmoni një buletin që u informon për gjithçka që ndodh në mjedisin Tuaj!



Buletini periodik **"PRESS"** u përgatit nga komisioni për komunikim me opinionin publik dhe Këshilli i Bashkësisë Lokale.

"PRESS" është i hapur për mendime, sugjerime dhe kritika.
"PRESS" ju fton për bashkëpunim!

NEVOJITET NJË BASHKËPUNIM I NDËRSJELLTË ME BASHKËATDHETARËT TANË

Çfarë mund të bëjmë për bashkëatdhetarët tanë dhe çfarë mund të bëjnë ata për vendlindjen e tyre? Cilët janë problemet kryesore të tyre? Si të ruhet identiteti kulturor dhe kombëtar i gjeneratës më të re të mërgimtarëve?

Përsa i përket diasporës shqiptare, që mund ta quajmë ndryshe si një degë e trungut, asaj gjithnjë duhet kushtuar kujdes të veçantë. Vazhdimisht thirremi në fuqinë materiale të diasporës, por shumë rrallë na kujtohet që të bëjmë më shumë për ta. Angazhimi i përhershëm i tyre për të ndihmuar projekte të ndryshme në vendlindje na obligon që edhe ne, si trung, të bëjmë më shumë për ta. Çka mund të bëjmë për bashkëatdhetarët tanë? Përgjigja do të ishte e thjeshtë: Mund të bëjmë shumëçka. Mbi të gjitha: t'i informojmë sa më detajisht me gjithçka ndodh në vendlindjen e tyre. Kjo sot është shumë e mundshme dhe shumë e lehtë. Mjetet e komunikimit masiv na mundësojnë këtë. Dhe pikërisht këto informata edhe u nevojiten atyre. Nëse diaspora vazhdimisht finanson projekte të ndryshme në fshat, ajo ka të drejtë të dijë nëse ato projekte realizohen apo jo. Duke mos qenë transparent me ta vetëm se mund të largojmë bashkëatdhetarët tanë nga vendlindja e tyre. Kuptohet, pa dëshirën e tyre.

PËR NJË INVESTIM NË VENLINDJE

Diasporës gjithashtu mund t'i ofrojmë edhe shumë gjëra tjera: duhet që të interesohemi sa më shumë që atyre t'u krijohet hapësirë për investim në vendlindje. Kjo do të mundësonte që ata të kishin interesin e tyre, por njëkohësisht do të ndikonte që të ulej shkalla e papunësisë.

Veç kësaj, në rast se do të organizoheshin përsa i përket rrafshit kulturor, do të mund të rrezatonin edhe në këtë aspekt atje.

Nga një takim që Bashkësia Lokale e fshatit Sllatinë pati me punëtorët tanë të punësuar në



botën e jashtme u vërejt se ata ndajnë shqetësimet për këtë mjedis, po aq sa i ndajmë edhe ne. Ata janë mjaft të interesuar që ky vend të jetë sa më i bukur, sa më i pastër, sa më i zhvilluar dhe i përparuar. Ata ishin të gatshëm për një bashkëpunim të ndërsjelltë, edhe në aspektin ekonomik. Ata janë të interesuar edhe për investime, por duan siguri për investimet e tyre, ndërkohë që B.L. nuk mund t'u sigurojë këtë. Kjo është detyrë e vetëadministratës lokale, e cila doemos duhet që të angazhohet në këtë drejtim dhe të vë kontakte me ta.

IDETË MIRËSEARDHURA

Bashkëatdhetarët tanë na ofruan edhe shumë ide të mirëseardhura dhe të dobishme. Na folën për funksionimin e bashkësive lokale të atjeshme, që për Këshillin e Bashkësisë Lokale është një përvojë më shumë. Këtë përvojë ata duan ta shohin edhe në vendlindjen e tyre, prandaj me të drejtë adresuan edhe disa kritika qëllim mira, që B.L. duhet t'i ketë parasyshë.

RUAJTJA E IDENTITETIT KOMBËTAR

Mbi të gjitha ata i shqetësonte ruajtja e identitetit kombëtar dhe kulturor të fëmijëve të tyre, një problem i theksuar për çdo mërgimtar, pa marrë parasyshë përkatësinë e tyre etnike. Humbja e identitetit kulturor dhe nacional të mërgimtarëve, veçmas të gjeneratave më të reja, është si pasojë e difuzionit kulturor, integritetit. Që të mund të zbutet ky fenomen, detyrimisht duhet të shtrihet ndikimi i këtushëm atje. Ky ndikim mund të bëhet edhe përmes këtij buletini. Veç kësaj si trung që jemi mund të reflektojmë atje më shumë vlera shqiptare. Janë të domosdoshëm edhe takime me bashkëatdhetarët tanë, këtu dhe atje. Duhet gjetur forma të organizimit të këtyre takimeve, veçmas kur është fjala për gjeneratën më të re të mërgimtarëve. Duhet ofruar atyre sa më shumë informacion për kulturën tonë, për vlerat tona, në atë formë që brezi i ri i mërgimtarëve ta ndjejë vendlindjen, kulturën e vet dhe të mos krijojë aversion ndaj saj.

Gjithashtu është e nevojshme që të këtu të afirmojmë sa më shumë sukseset e mërgimtarëve tanë në botën e jashtme. Kemi shumë afaristë të suksesshën, shumë studentë, shumë sportistë. Fatkeqësisht shumë pak i afirmojmë.

Me një informim të ndërsjelltë mund të bëhet edhe kjo gjë.

QASJE A DUHET TË RINGJALLIM SHOQËRINË ARTISTIKE?

Përse duhet të kemi SHKA, si mund të organizohemi dhe a është e vështirë të bëhet kjo?

Mbase kjo pyetje është parashtruar gabimisht. Mbase do të ishte më mirë që të parashtrohej ndryshe: përse duhet që të kemi një SHKA? Dhe përgjigja do të ishte si vijon: Secili fshat i ka veçantitë e veta kulturore, prandaj duhet që t'i prezantojë ato. Veç kësaj një SHKA, brenda të cilës do të funksiononin edhe seksionet e ndryshme artistike (dramës, poezisë, valles etj.) do të ishte një forcë afruese dhe kreative për të rinjtë dhe të rejtat e fshatit. Njëherit do të kishte ndikim edhe në kultivimin e talentëve të rinj, përsa i përket artit.

Si mund të organizohemi dhe a është e vështirë që të bëhet kjo?

Mënyra më e mirë do të ishte që komuna e Tearcës të kishte një program kulturor. Madje një program kulturor jo vetëm për zhvillimin e SHKA-ve, pra amatorizmit, por një program të njëmendtë kulturor ku do të përkraheshin edhe projekte më të avancuara kulturore. Meqenëse kjo komunë nuk ka program të këtillë dhe nëse e ka ajo mbase e mban vetëm në sirtarë dhe deri më sot nuk kemi shënuar ndonjë rast të realizimit të ndonjë programi të këtillë, atëherë, fatkeqësisht, na duhet vet të organizohemi. M'u sikur atëherë kur Alirami Xhelili me të hollat e veta bleu rekuizitat dhe instrumentet.

Talentë ka. Mungojnë vetëm mjetet financiare. Megjithatë edhe mjetet mund të gjenden nëse ngulmohet.

SHKA «Vëllazërimi» është organizuar edhe në kohëra shumë më të vështira, atëherë kur survehohej puna e saj, kur duhej që çdo këngë të përkthehej nga frika e oktopodit komunist se mos përmbajtja e këngëve kishte elemente të »rrezikshme« për shtetin. Dhe kur kemi mundur të organizohemi atëherë kur e kishim më vështirë, besojmë se mund të organizohemi edhe tani. Le ta marrim hapim e parë. Pastaj gjithçka do të jetë e lehtë. Puna e mëtutjeshme do të na krijojë kënaqësi.



Në foto mund të shihen disa doajenë të SHKA "Vëllazërimi". Fotoja e mësipërme është bërë gjatë një parakalimi të SHKA-së në një festival, shumë vite më parë, ndërkaq në foton e mëposhtme janë disa anëtarë të SHKA-së posa ishte themeluar ajo.

LIBRI



»PANTEONI I UTOPIË« NJË LIBËR ME ESE

«Panteoni i utopisë», kështu quhet libri i autorit Salajdin Salihu, që është botuar nga Shtëpia Botuese »Shkupi«. Libri përmban ese, udhëpërshkrime, vështrime letrare dhe impresione personale. Në këtë libër autori ka përmbledhur shkrime që kanë qenë të botuar nëpër gazeta dhe revista të ndryshme. Salajdin Salihu është autor i pesë librave. Krijimet e tij letrare janë përfshirë nëpër shumë antologji. Poezitë e tij janë përkthyer në disa gjuhë. Autori ka lindur dhe jeton në Slatinë.



Në këto foto mund të shihni disa nga mësuesit e parë të fshatit Sllatinë.



Lusim të gjithë ata që kanë fotografi të vjetra të na i dërgojnë në redaksinë e buletinit “**PRESS**”.

Redaksia garanton kthimin e fotografive.



Nga ky numër në "Sllatina INFO" do të keni mundësi që të ndiqni me vazhdimë punimin shkencor për pozitën gjeografike të komunës së Tetovës të autorit Agron Salihu, gjeograf i diplomuar, ku flitet për pozitën gjeografike, kushtet natyrore të territorit të komunës, historinë e popullimit të kësaj treve; situatën ekonomike në komunën e Tearcës etj.

POZITA GJEOGRAFIKE, KUFINJTË DHE MADHËSIA E KOMUNËS SË TEARCËS (2)

Shkruan: Agron SALIHU

PASURITË UJORE

Komuna e Tearcës në përgjithësi është e pasur me ujë. Ndër rrjedhjet sipërfaqësore më kryesoret janë lumenjtë: Bistricë, Leshkë (që kalon nëpër fshatin Sllatinë, 14.5km i gjatë) dhe Dobroshtit. Të gjithë këta lumenj janë degë të Vardarit. Bistrica e Tearcës buron lart në Malin Sharr. Njëri prej burimeve të saj ndodhet në lartësinë mbidetare 2.520m. Ky lumë rrjedh prej veriperëndimit në juglindje, duke kaluar nëpër fshatin Tearcë (550 m mbi nivelin e detit). Më tej Bistrica ndahet në dy degë: njëra derdhen në lumin Vardar afër fshatit Jançisht, ndërsa tjetra afër fshatit Podbreg. Lumi i Leshkës buron në vendin e quajtur Presllap, në lartësinë mbidetare 2.240 m. Rrjedh në drejtimin veriperëndim-juglindja. Në fshatin Leshkë ai rrjedh në lartësinë 550 m, si një lumë malorë. Në rrëzë të malit Sharr lumi i Leshkës rrjedh në një terren me pjerrësi të vogël deri sa i bashkohet Vardarit afër fshatit Përlubisht. Lumi i Dobroshtit formohet prej shumë burimeve, të cilat gjenden në malin Sharr, në lartësitë mbidetare 2.260, 2.300 dhe 2.500m. Vendi ku gjendet burimi kryesor quhet Grabovnica. Prej burimeve deri në fshatin Dobrosht ai ka karakteristikat e një lumi malor (lartësia 550m mbi nivelin e detit). Më tej lumi rrjedh nëpër një luginë të rrafshhtë deri në lumin Vardar, afër fshatit Jegunovcë. Në vjeshtë dhe dimër sasia e ujit në këto lumenj shtohet. Shpesh herë ata vërshojnë duke i shkaktuar dhe popullsisë së komunës dëme materiale të mdha. Tokat e punueshme mbushen me gurë e rërë dhe shndërrohen në toka të papunueshme. Megjithatë, rëndësia ekonomike e këtyre lumenjëve është e madhe. Gjatë muajve të verës ujërat e këtyre lumenjëve përdoren për

ujitjen e tokave bujqësore. Ata janë të pasur me peshq (trofta), mirëpo kohët e fundit ujërat e tyre janë shumë të ndotura sepse në to hidhen të gjitha mbeturinat e fshatrave nëpër të cilat ata kalojnë. Për shkak të ndotjes, një pjesë e madhe e botës së gjallë në këta lumenj po zhduket.

Ndër pasuritë ujore, interes të veçantë paraqesin liqenet akullnajore apo, siç quhen ndryshe, "Sytë e malit". Të tillë janë liqeni i Epërm dhe i Poshtëm në fshatit Dobrosht etj. Rëndësi të veçantë kanë burimet e ujrave minerale, sidomos ato në fshatrat Sllatinë, Tearcë, Leshkë etj.

LLOJET E TOKAVE

Në territorin e komunës së Tearcës gjenden këto lloje tokashve: toka të kuqe (tarrarosa), të cilat më së shumti janë të përhapura në viset argjilore të fshatit Nerashit. Në këto toka rriten pyjet e ulta. Ato janë mjaft pjellore dhe të përshtatshme për kultivimin e drithrave.

Tokat aluviale formohen si rezultat i shtresëzimit të materialit të imtë lumor pranë shtretërve të lumenjëve. Këto toka zënë një pjesë të madhe të sipërfaqes së komunës. Ato janë mjaft pjellore dhe të përshtatshme për kultivimin e të gjitha kulturave bimore që kërkojnë shumë lagështi si: perimet, misri etj, ndërsa nga bimësia natyrore në këto toka rriten lloje të ndryshme të barishteve, shelgjet etj.

Tokat podzole (të hinjta) takohen në viset pyjore, ku bimësia pyjore e pengon avullimin e shpejtë të lagshisë. Në kushte të tilla uji e bart humusin në shtresat më të thella të dheut, proces që i bën këto toka më pak pjellore se tokat e zeza. Përveç se me bimësi natyrore (pyje), tokat podzole mund të kultivohen edhe me drithëra.

Tokat e kafejta (ndryshe quhen toka pyjore), krijohen në shkëmbinj të thatë dhe silikate që takohen kryesisht në

fshatrat Sllatinë dhe Leshkë, ku gjenden edhe burimet e ujërave minerale.

BOTA BIMORE DHE SHTAZORE

Bimësia natyrore në komunën e Tearcës përbëhet nga pyjet dhe barishtet. Pyjet mbulojnë 3.666 hektarë ose 28.6% të sipërfaqes totale të komunës. Pjesa më të mdha e pyjeve janë gjethtërenëse me lis, por në brezin e pyjeve të lisit gjenden edhe pyje ahu, dushku, shkoz, plepi etj. Gjithashtu, është mjaft e përhapur edhe gështenja e butë. Pyjet gjethtëmbajtëse të halorëve shtrihen mbi brezin e pyjeve të ahut, në disa pjesë të larta të malit Sharr.

Bimësia e ulët (barishtet) hasen në formën e livadheve dhe kullotave, të cilat rriten në ato pjesë të territorit të komunës kryesisht ku gjejnë kushte të përshtatshme. Kullotat zënë 4.400 hektarë ose 34.3% të sipërfaqes së komunës, ndërsa kullotat shtrihen kryesisht mbi katin e pyjeve, por edhe midis tyre. Ndërkohë sipërfaqet bujqësore përfshijnë 12.827 hektarë, nga të cilat 4.761 hektarë ose 37.1% janë tokë e papunuar. Pjesa fushore e komunës është e kultivuar, kryesisht me drithëra, bimë foragjere, pemë, perime etj.

Komuna e Tearcës ka gjithashtu një botë shtazore (faunë) mjaft të pasur. Kështu në malin e Sharrit rritet ariu, rreqebulli (mjaft i rrallë në Evropë), kaprolli, dhija e egër (që jeton në pjesët shkëmbore dhe të larta të maleve), ujku, derri i egër dhe dhelpira. Kjo zonë e Sharrit është shumë e pasur me lloje të ndryshme shpendësh, prej të cilëve më të pranishëm janë: petriti, shqiponja dhe huti (bufi), por takohen edhe thëllënza, kumrija, korbi, pula e egër e cila në vende tjera thuhet se është zhdukur.

(Vazhdon në numrin e ardhshëm)